

Zëvendësdrejtori i FIQ merr pjesë në konferencën ndërkombëtare lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen, mbajtur në Beograd



Prishtinë, 29 janar – Zëvendësdrejtori ekzekutiv i Forumit për Iniciativa Qytetare (FIQ), Nazim Haliti, ka marrë pjesë më 28 janar në konferencën ndërkombëtare të organizuar në Beograd nga Qendra për Studime Euro-Atlantike në temën: “Serbia, Ballkani Perëndimor dhe BE-ja: çfarë kemi të përbashkët në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, dhe si të punohet në drejtim të stabilitetit dhe progresit në rajon”. Në këtë konferencë, ku kanë marrë pjesë mbi 70 pjesëmarrës, përfshirë organizata dhe studiues nga Sllovakia, Çekia, Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, si dhe zyrtarë shtetëror dhe organizata të shoqërisë civile dhe medias nga Serbia, zëvendësdrejtori Haliti ka prezentuar në panelin ku është diskutuar për sfidat dhe arritjet e vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin e Politikave të Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP).

Në paraqitjen e tij, Haliti ka folur për zhvillimin dhe reformat në sektorin e sigurisë në Kosovë, prezencën dhe kontributin e institucioneve dhe misionëve ndërkombëtare, si KFOR dhe EULEX, si dhe për verin e Kosovës si potencial i vazhdueshëm i cenimit të sigurisë në vend.

Jelekë ndriçues për të shtruar sigurinë e nxënësve në rrugë

Prishtinë, 31 janar – Si pjesë e programit të përbashkët të punës së FIQ dhe Saferworld, ditë më parë, organizatat tona kanë financuar me një grant prej 1,500 euro blerjen e jelekëve të gjelbër ndriçues për 652 nxënës të shkollës fillore “28 Nëntori” në Raushiq.

Nxënësit dhe banorët e këtij fshati ndër vite i ekspozohen rrezikut në komunikacion. Vetëm në periudhën janar-nëntor 2012 në Raushiq kanë ndodhur 21 aksidente, me 31 të lënduar, ka thënë zyrtari policor Fadil Gashi, në një takim të FIQ dhe Saferworld me Këshillin e Komunitetit të Raushiqit. Drejtori i shkollës, Ismet Zekaj, ka thënë se “nxënësit tanë janë shumë të rrezikuar dhe se e vetmja formë e mbrojtjes së nxënësve është parë pajisja e tyre me jelekë të gjelbër, ndonëse kjo nuk e shmangë rrezikun në tërësi”.

FIQ ka mbështetur komunitetin e Raushiqit në adresimin e problemeve të sigurisë në bashkësi që nga viti 2008. Së fundmi, kemi inicuar dhe përkrahur edhe idenë e angazhimit të një qytetari, i cili njëjtë me jelek të gjelbër dhe me shenjën e “Stop”-it luan rolin e policit afër shkollës për t’u kujdesur për nxënësit në vajte-ardhje në shkollë dhe për të drejtuar automjetet në afërsi të shkollës.



FIQ prezanton konceptin e sigurisë në bashkësi në Kuvendin Komunal të Shtimes



Prishtinë, 31 janar - Në kuadër të programit të përbashkët të punës së FIQ dhe Saferworld për të mbështetur nismat dhe projektet e sigurisë në bashkësi, si dhe punën dhe funksionimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), të hënën zëvendësudrejtori i FIQ, Nazim Haliti bashkë me kolegët nga Saferworld kanë mbajtur një prezantim në Kuvendin Komunal në Shtime, lidhur me rolin dhe funksionimin e KKS-së në rritjen e sigurisë në bashkësi. Ai ka njoftuar KK-në me punën e KKS-së, e cila me udhëzimin e ri administrativ themelohet dhe i raporton Kuvendit Komunal, pastaj me Strategjinë Nacionale për Siguri në Bashkësi (MPB), e cila parasheh ndërveprimin e shumë institucioneve qendrore dhe lokale në adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të sigurisë së qytetarëve në bashkësitë e tyre.

FIQ dhe Saferworld gjatë dy viteve të fundit kanë mbështetur tre projekte të sigurisë në bashkësi në Shtime: ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimin publik për shkollën e mesme “Naim Frashëri”; instalimin e kamerave në qytet dhe në shkollën e mesme “Naim Frashëri”; një fushatë për vetëdijësimin e qytetarëve për mjete piroteknike dhe mosgjaujtje me armë gjatë festave të fundvitit dhe ligjerata me nxënës lidhur me sigurinë në shkolla.

Njiheni policin tuaj – kanë vazhduar takimet me qytetarë

Prishtinë, 7 shkurt 2013 - “Njiheni policin tuaj”, është motoja e fushatës tremujore të organizuar nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Kjo fushatë ka për qëllim që drejtpërsëdrejti t’u ofroj informacion qytetarëve lidhur me atë që tashmë njihet si “policimi në komunitet”, e që është filozofi e re e punës së policisë. Kjo formë e punës, ka për qëllim të ofroj sa më shumë qytetarët me policinë, që qytetarët të dijnë se ku mund të drejtohen, jo vetëm kur rastisin në ndonjë vepër, por edhe të kontribuojnë në parandalim.

Në maj të vitit 2012, Policia e Kosovës, ka filluar zbatimin e strategjisë “Policimi në bashkësi”, sipas së cilës, ndarja në sektore mundëson që çdo vendbanim i përket një sektori, ku janë zyrtarët e caktuar policor, e që punojnë vetëm në atë zonë. Këta zyrtarë policor, janë në komunikim të vazhdueshëm dhe të drejtpërdrejtë me qytetarë, ku këta të fundit lirshëm mund të raportojnë rastet e ndryshme që mund të shkaktojnë pasiguri në komunitetin e tyre. Është kjo formë e punës së policisë, e cila si rezultat i krijimit të besimit mes qytetarëve dhe policisë, i kontribuon sigurisë në vendbanime dhe e lehtëson punën e policisë.

FIQ dhe Policia e Kosovës, në muajin dhjetor 2012, filluan fushatën “Njiheni policin tuaj”, ku deri tani aktivitetet e takimeve të rastit dhe debateve me qytetarë janë realizuar në Prishtinë, Suharekë, Kaçanik, Viti, Drenas, Rahovec dhe Shtërpçë. Qytetarëve u janë shpërndarë fletushka njoftuese, të cilat përmbanin konceptin e policimit në bashkësi dhe numrat e telefonit pa pagesë, në mënyrë që qytetarët të dijnë ku të drejtohen.

Nga diskutimet e qytetarëve, një nga problemet kryesore del të jetë mungesa e besimit të qytetarëve për të raportuar rastet apo për të dëshmuar, si dhe intervenimi i ngadaltë dhe shpesh i vonuar i policisë, sidomos në rastet kur ka mundësi të kapen kryesit në vepër. Një problem që u diskutua pothuajse në të gjitha takimet me përfaqësues fshatrash, ishte ndërrimi i shpeshtë që u bëhet zyrtarëve policor të sektorit, e zgjidhja për këtë problem, nëse duhet detyrimisht të ndërrohet zyrtari i sektorit, të jetë një numër i caktuar telefoni, i cili do të vazhdojë t’i takoj sektorit edhe nëse ka ndërrim të zyrtarit të sektorit, ose të obligohen zyrtarët e rinjë të sektorit të lajmërojnë të gjithë përfaqësuesit e fshatrave dhe lagjeve të zonës së caktuar për ndërrimet.

Artikullin mbi Strategjinë e Policimit në Bashkësi mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm

[Papërgjegjësia Strategjike, nga Arieta Rexhepi](#)



Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives

Lagja Aktash, Rr. Rexhep Mala 5/A 10 000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 248 677 +386 (0) 43 733 454 | info@fiq-fci.org | www.fiq-fci.org

Publikimi i analizës “Krim i rëndë, vetëm në letër – politika e ndjekjes dhe dënimeve në rastet që ndërlidhen me armë”

Në tryezën e organizuar nga Forumi për Siguri, ku ishin pjesëmarrës kryeprokurorë, gjykatës, përfaqësues nga Policia e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucione tjera që merren me çështjen e sigurisë, u publikua dhe diskutua analiza me titull “Krim i rëndë, vetëm në letër – politika e ndjekjes dhe dënimeve në rastet që ndërlidhen me armë”.

Kjo analizë, vështron dhe analizon politikat ndëshkuese për veprat penale që ndërlidhen me armë. “Veprat penale që ndërlidhen me armët janë ndër veprat më të shprehura në Republikën e Kosovës. Kemi një ndërlidhje mjaft të ndërlidhur në mes të armëmbajtjes dhe krimeve tjera. Në një anë armët janë burim i vrasjeve, plagosjeve, grabitjeve dhe kanosjeve të ndryshme. Dhe në anën tjetër, armët shërbejnë si masë mbrojtëse për shkak të pasigurisë së qytetarëve për jetën dhe pronën e tyre. Kjo pasiguri vjen edhe si rezultat i dështimit të institucioneve të drejtësisë për të ndjekur dhe dënuar në mënyrë meritore kryesit e vjedhjeve dhe grabitjeve”, tha në tryezë, Betim Musliu, hulumtues në Institutin Kosovar të Drejtësisë, njëherësh edhe njëri nga autorët e analizës.

Sipas analizës, del se sistemi i drejtësisë në Kosovë nuk trajton të gjithë qytetarët të barabartë para ligjit. Në mungesë të unifikimit të politikës së dënimeve, dënimet kanë qenë të ndryshme brenda gjykatës së njëjtë e po ashtu edhe në mes të gjykatave të ndryshme. Një problem tjetër thelbësor në sistemin e drejtësisë është vjetërsimi i lëndëve. Nga viti 2008 deri në tetor 2012, numri i lëndëve të pazgjidhura është rritur për 27% duke shkuar nga 1,324 në 1,681 lëndë.

Të pranishmit në tryezë, pro et contra edhe mes vet institucionit të gjyqësisë dhe prokurorisë, diskutuan mbi ashpërsimin e politikave ndëshkuese, duke pasur parasysh se pa politika të ashpra ndëshkuese, nuk do të arrihen rezultate në këtë drejtim. Faktori socio-ekonomik nuk do të duhej të merrej parasysh në rastet e dënimeve të poseduesve dhe përdoruesve të armëve të jashtëligjshme, u tha nga shumë zyrtarë, pasi që u potencua disa herë se gjatë shqiptimit të dënimit për veprën e armëmbajtjes, merret në konsideratë gjendja ekonomike e të akuzuarit.

Publikimin “Krim i rëndë, vetëm në letër; Politikat e ndjekjes dhe dënimeve që ndërlidhen me armët”, e gjeni [KETU](#).



Instituti për Studime të Avancuara GAP dhe Forumi për Iniciativa Qytetare

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Lidhur me publikimin e analizës “Çmimi i Energjisë Elektrike: trendët e ndryshimit dhe ndikimi ekonomik”

Instituti GAP dhe FIQ, në kuadër të Konsorciumit të Organizatave Jo Qeveritare për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), sot më 10 mars 2013, në një konferencë për media, publikuan analizën “Çmimi i Energjisë Elektrike: trendët e ndryshimit dhe ndikimi ekonomik”. Kjo analizë trajton metodologjinë e përdorur nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për të përllogaritur çmimet e energjisë elektrike, si dhe në këtë analizë jepen rekomandime se si Qeveria e Kosovës mund të ndikoj që të mbaj të ulët çmimin e energjisë elektrike.

Kushtrim Puka nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), shtjelloi problematikën e çmimit të energjisë në krahasim me fuqinë blerëse të kosovarëve. Në krahasim me vendet e rajonit, Kosova paguan më shumë për kWh sesa Serbia dhe Maqedonia, ndërsa çmim më të ulët se Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Mali i Zi. Kurse 27 vendet e Bashkimit Evropian në mesatare paguajnë rreth 14.16 cent për kWh, apo rreth 3 herë më shumë sesa Kosova.

Komunikatën e plotë për media, mund ta gjeni [KETU](#).

**Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives**

Lagja Aktash, Rr. Rexhep Mala 5/A 10 000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 248 677 +386 (0) 43 733 454 | info@fiq-fci.org | www.fiq-fci.org

FIQ dhe Fshati Smirë bartin përvojën e aktivizmit qytetarë nëpër Kosovë

Duke parë punën e mirë të banorëve të fshatit Smirë dhe duke e cilësuar këtë fshat si shembull të aktivizmit qytetar, Forumi për Iniciativa Qytetare, në kuadër të projektit “Rritja dhe forcimi i aktivizmit qytetarë”, po organizon takime në dhjetë fshatra të komunave të ndryshme të Kosovës. Në këto takime, punën e mirë të fshatit Smirë, po e paraqesin udhëheqësi i Këshillit të fshatit Smirë, z. Bekim Azizi, i cili thotë se Këshilli të cilin ai e drejton ka bërë planet zhvillimore për shtatë vitet e ardhshme.

Fillimisht ky model- shembull i është prezantuar udhëheqjes së fshatrave Dardani dhe Gaçkë të Ferizajt si dhe Fshatit Zllakuçan.

“Qëllimi i këtij aktiviteti brenda projektit tonë ka të bëjë me mbështetjen, me nxitjen e aktivizmit qytetar. Ajo që ka arritur ta bëjë Smira, është që përveç punëve të mira brenda fshatit, ata e kanë promovuar punën e tyre edhe përmes uebfaqes së tyre që e mirëmbajnë. Ndërsa ne si organizatë, tani po e promovojmë Smirën te komunitetet tjera që t’i nxisim njerëzit, që pak energji edhe vullnet që kanë ta transformojnë në aktivitete praktike. Natyrisht, gjithmonë në të mirë të bashkësisë ku jetojnë, në lagje apo fshat”, shton Nazim Haliti, nga FIQ.

Ata që e ndoqën prezantimin e modelit të organizimit dhe aktivizimit, patën rastin të mësojnë dhe të marrin shembull si të organizohen dhe të punojnë në të ardhmën për të mirën e komunitetit që e përfaqësojnë. Forumi për Iniciativa Qytetare-FIQ, ka përcjellë dhe ka ndihmuar dy vitet e fundit smirasit dhe përmes Smirës do t’i nxisë edhe qytetarët tjerë për t’u aktivizuar.

“Ne nga ky prezantim kemi mësuar shumë dhe kemi parë shumë të arritura të mira, si projekte të mira, punë të mirë, e që besoj se edhe ne këto projekte ti zbatojmë në fshatin tonë dhe do të marrim këso nisma”, thotë kryetari i këshillit të fshatit Dardani, Besim Xhakli.

Edhe Shaqir Sejdiu nga fshati Gaçkë, tha se ky takim ishte i mirë se ardhur dhe do t’u shërbejë për organizim edhe më të mirë, në fshat. “Përvojat kurdoherë janë të mira të shkëmbehen, ne jemi mjet aktiv si fshat, por këtu pamë disa projekte të vogla dhe ide interesante të cilat mund të na hyjnë në punë edhe neve, u shpreh Sejdiu.

FIQ, parasheh ligjëratat dhe prezantime edhe në tetë fshatra tjera, në Gjakovë, Pejë, Klinë dhe Gjiilan, nga administratori i fshatit Smirë, Bekim Azizi dhe njëri nga mirëmbajtësit e faqes www.fshatismire.com, Tefik Salihu.



FIQ dhe Smira përfundojnë ciklin e takimeve nëpër Kosovë për qytetari aktive

Me takimet në fshatrat Korishë dhe Skorobishtë të Prizrenit, Forumi për Iniciativa Qytetare-FIQ dhe Smira, kanë përfunduar ciklin e ligjëratave për qytetari aktive, në kuadër të projektit “Rritja dhe forcimi i aktivizmit qytetar”, të kryesuar nga FIQ. Kryetari i deritanishëm i Smirës, Bekim Azizi dhe njëri nga mirëmbajtësit e faqes së internetit www.fshatismire.com, Tefik Salihu, kanë prezantuar para këshillave dhe aktivistëve të 10 fshatrave, në pesë komuna të Kosovës modelin e organizimit dhe realizimit të iniciativave, aksioneve e projekteve në baza vullnetare në Smirë.

Zëvendësudrejtori i FIQ-it, Nazim Haliti, shprehet se nga të gjitha takimet është parë gatishmëria e qytarëve për të qenë aktiv në zhvillimin e aktiviteteve në të mirë të komunitetit. “Në përgjithësi shohim që çdo komunitet ka njerëz që kanë përkushtim t’ia dedikojnë kohën dhe dinë e tyre punëve dhe interesave të komunitetit, por ata gjithë këtë punë e bëjnë pa patur kushte pune dhe mbështetje nga tjerët. Por ajo çfarë jemi përpjekur të diskutojmë me ta është ajo që ata nuk duhet parë aktivizmin qytetar vetëm në raport me institucionet lidhur me nevojat e tyre infrastrukturore, por që të jenë të organizuar brenda komunitetit të tyre në aktivitete të tjera të vogla mjedisore, kreative dhe sociale”, thotë Haliti.

Sipas Haliti, prezantimi i modelit të Smirës është mirëpritur nga të gjithë. “Kam përshtypjen se Smira i ka nxitur që të forcojnë nivelin e angazhimit të tyre. Disa madje kanë kërkuar dokumente të ndryshme të prezantuara dhe të tjerë që janë interesuar që të mbajnë lidhjen dhe komunikimin me Smirën”, tha zëvendësudrejtori i FIQ-it, Nazim Haliti. Haliti tha se bashkëpunimi i FIQ me Smirën do të vazhdojë edhe në të ardhmen në kuptimin e nxitjes së ideve të reja dhe në forcimin e aktivizmit qytetar në vend.

Bekim Azizi, ndërkaq tha se është ndjenjë e mirë kur puna dhe organizimi i Smirës është vënë re dhe është vlerësuar nga FIQ-i dhe ky model i funksionimit u është prezantuar edhe të tjerëve.



**Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives**

Lagja Aktash, Rr. Rexhep Mala 5/A 10 000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 248 677 +386 (0) 43 733 454 | info@fiq-fci.org | www.fiq-fci.org

Forumi për Iniciativa Qytetare fillon takimet me Rotarianët Kosovarë

Prishtinë, Prill 2013, Dajana Berisha – Drejtoreshë Ekzekutive dhe Vjollca Islami Hajrullahu - Zyrtare e Programit të Filantropisë në FIQ u takuan ditën e djeshme me anëtarët e Rotary Club të Ferizajt. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja, shkëmbimi i informacioneve dhe eksperiencave përkatëse në fushën e aktivizmit qytetar, specifikisht në fushën e Filantropisë. Kosova është pranuar në Rotary International më 4 nëntor 2005, dhe tani në Kosovë janë rreth 250 Rotarianë. Rotarianët Kosovarë janë duke promovuar vlerat e rotarisë dhe duke ofruar shërbimet e tyre në fushën e shëndetit, analfabetizimit, mjedisit, ujit, programeve ambasadoriale dhe të shkëmbimit mes studentëve, projekteve të varfërisë, dhe projekte tjera. Poashtu Rotarianët Kosovarë e mbështetin edhe projektin Polio Plus dhe kanë bashkëpunim të mirë me Klubet Rotariane në Evropë, SHBA dhe në mbarë botën.

Në Kosovë janë nëntë klube rotariane. Rotary Club Ferizaj deri më tani kanë të realizuar mëse 50 projekte të ndryshme, vetëm brenda këtij viti ata kanë arritur të realizojnë rreth 5 projekte. Bibliobusi është projekti i cili ka arritur shumën e financimit rreth 38 mijë dollarë, i cili projekt përmes këtij Bibliobusi i ofron shkollatë të viseve rurale të Ferizajt qasje në libra bibliotekar.

FIQ beson se me realizim të bashkëpunimeve me Rotary Clubet, puna e mrekullueshme filantropike do t'i mundësojë Kosovës zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.



Artikullin mbi Filantropinë mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm:

[Filantropia - Arti i Ndarjes së të Mirës, nga Vjollca Islami Hajrullahu](#)

FIQ merr pjesë në protestën e organizuar nga IZHL në Obiliq

Prishtinë, 4 Prill 2013, FIQ morri pjesë në protestën e organizuar nga Iniciativa për Zhvillim Lokal, me moton "Edhe ne kemi të drejtë të marrim frymë".

Qëllimi i protestës ishte adresimi i çështjeve që lidhen me nivelin e lartë të ndotjes, numrin e madh të të sëmurëve nga pasojat e këtyre ndotjeve, mungesën e përkrahjes së veçantë për banorët e Obiliqit në ruajtjen e shëndetit publik, pastaj mungesën e projekteve mjedisore dhe hapësirave të gjelbërta.

Protesta u zhvillua në qendër të Obiliqit, ku morrën pjesë qindra qytetarë, ku pas një defileje u mbajt fjalimi nga organizatorët, të cilët adresuan brengat e qytetarëve të kësaj komune.



FIQ mban ligjeratë për projektet energjetike në Kosovë

Prishtinë, Mars 2013, Forumi për Iniciativa Qytetare, FIQ, në kuadër të Konsorciumit Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm, KOSID, mbajti ligjeratë për nxënësit e shkollës së mesme "7 Shtatori" në Prishtinë, me temën, Zhvillimi i Sektorit të Energjisë në Kosovë.

Në ligjeratë u paraqitën qëndrimet kryesore të KOSID-it dhe aktivitet që janë mbajtur gjatë gjithë vitit. Përveç kësaj, ligjërata përfshiu edhe informacione kritike në lidhje me zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë gjatë dekadës së fundit, diskutime dhe analiza për projektet e mëdha në këtë fushë, rolin e institucioneve ndërkombëtare si Banka Botërore, IFC dhe USAID-it në projekte të tilla, diskutimet mbi potencialin e burimeve të ripërtërishe të energjisë në Kosovë dhe atë se çfarë duhet të bëhet në lidhje me arritjen e një të ardhmeje të qëndrueshme për sektorin e energjisë në Kosovë, në përputhje me direktivat e BE-së.

Diskutimet interaktive gjatë gjithë ligjërates mundësuan që nxënësit të mësojnë më shumë për çështje të ngutshme dhe zhvillimet në sektorin e energjisë dhe të informohen me punën e bërë nga organizatat e shoqërisë civile për të adresuar këto çështje. FIQ do të vazhdojë me këto ligjerata edhe në shkollat tjera, ndërsaq deri tani janë mbajtur ligjerata gjithsej në shtatë shkolla.

Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives

Lagja Aktash, Rr. Rexhep Mala 5/A 10 000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 248 677 +386 (0) 43 733 454 | info@fiq-fci.org | www.fiq-fci.org



FIQ përkrah debatin Rritja e qasjes së grave në pushtetin lokal dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje



Shtime, Prill 2013, Gratë në Biznes, e përkrahur nga Forumi për Iniciativa Qytetare ka filluar implementimin e projektit “Rritja e qasjes së grave në pushtetin lokal dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje”, i cili synon që të avansojë pozitën e gruas dhe t’i kontribuojë barazisë gjinore duke ndihmuar dhe lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve komunale / me theks të veçantë të atyre të sektorit të ekonomisë dhe grave, si dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e grave në proceset e planifikimit të buxheteve komunale.

Bazuar në të dhënat e Zyrës Statistikore të Kosovës Papunësia e grave është 62%, krahasuar me atë të burrave që është 35%. Gratë zënë 29% të ulësve në parlamentin e Kosovës. Nga 13 komisionet e Kuvendit vetëm 2 udhëhiqen nga gratë. Pjesëmarrja e grave në Kuvendet komunale është nga 22 deri në 28%, kurse akoma nuk ka asnjë grua kryetare të komunës. Kuota e paraparë me ligj për pjesëmarrje të grave në institucione është akoma larg të arrihet. Mungesa e përkrahjes, gara e pabarabartë, dekurajimi, janë disa nga faktorët që bëjnë që gratë të marrin pjesë në politikë vetëm 17%.

Projekti synon bashkëpunim të ngushtë me kryetarët e komunave dhe të zyrtarëve/eve/ për barazi gjinore në komuna si dhe me këshilltarë komunalë. Projekti do të realizohet në partneritet me Agjensionin Për Zhvillim Rajonal – Qendër. Poashtu gjatë projektit do të bashkëpunohet ngushtë edhe me OJQ-në dhe me grupin e Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, për të avokuar në nivelin qendror dhe me zyrtarët për barazi gjinore, që të përkrahen nismat në nivel lokal.

Projekti do të mobilizojë gratë që kanë treguar një lidhshmëri në fushën e ndërmarrjes që janë pjesëmarrëse aktive në shoqëri, duke qenë fillimisht të mire informuara për mundësitë ekonomike që kanë në nivelet komunale dhe për mundësitë që mund të krijojnë së bashku qytetarët, komuna dhe shoqëria civile.

Gjatë projektit do të organizohen së paku 8 debate nga një në komunë, ndërmjet autoriteteve komunale dhe grave ndërmarrëse, ku gratë do të njihen me planin zhvillimor të komunave, mundësitë ekonomike për gratë dhe njëherit do të kenë mundësi të japin pikëpamjet dhe rekomandimet e tyre për planet zhvillimore dhe rishikimin e tyre, me një qasje të perspektivës gjinore.

Në njërin nga debatet, atë në komunën e Shtimës, nga FIQ, morri pjesë znj. Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive, e cila si paneliste, foli për rëndësinë e gruas në shoqëri dhe rolin që ajo mund dhe ka potencial të luaj qoftë në procese vendimmarrëse qoftë në afarizëm.



FIQ bëhet anëtare me të drejta të plota në projektin SIGN

Ohër, Prill 2013, FIQ, u bë anëtare me të drejta të plota në projektin rajonal të financuar nga Komisioni European, “SIGN for Sustainability”, objektivat e të cilit konsistojnë në rritjen e qëndrueshmërisë dhe ndikimit të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor, në ngritjen e zërit dhe influencës së qytetarëve në procesin e reformave të sektorit publik. Aktivitetet e projektit përfshihen në tri çështje kryesore: përmirësimi i kornizës ligjore për filantropi, shkëmbimi i njohurive dhe promovimi i praktikave më të mira, duke rritur mbështetjen dhe angazhimin e qytetarëve në shoqërinë civile.



Forumi për Iniciativa Qytetare fillon me ligjërata për Filantropinë

Prishtinë, Mars 2013, Forumi për Iniciativa Qytetare fillon me realizimin e muajit të Filantropisë, pjesë e së cilës janë edhe takimet me studentët e Universiteteve në Kosovë.

Vjollca Islami Hajrullahu- Zyrtares e Programit të Filantropisë, ka vizituar Universitetin Amerikan të Kosovës për të realizuar një prezantim për Filantropinë, i cili është pasuar me diskutime nga studentët e këtij Universiteti.

Klubi bamirës i Universitetit Amerikan janë fitues të Çmimit Fides 2012 të cilët falë punës së tyre të mrekullueshme duhet të jenë shembull edhe për studentët që vijnë në mësimet në Universitetet e tjera.

FIQ përmes këtyre takimeve ka për qëllim promovimin e Filantropisë dhe rritjen e numrit të Filantropëve.



Forumi për Iniciativa Qytetare organizoi tryezën për "Biznes Plane – Të gjelbërta dhe Inovative" 2013.

Prishtinë, Prill 2013, Tryeza e organizuar në ambientet e Hotel "Sirius" kishte për synim shpjegimin sa më të detajuar për thirrjen e publikuar "Biznes Plane – Të gjelbërta dhe Inovative".

Ky projekt ka për qëllim të identifikojë dhe tërheq sipërmarrësit e rinj në Kosovë, duke ofruar mundësinë për të marrë financim fillestar nga donatorët dhe filantropistët, për idetë e tyre të biznesit.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të identifikojë dhe të mbështes biznes plan që ka potencial të lartë për sukses, një të tillë që tregon ndikim të rëndësishëm social, mjedisor dhe ekonomik për një komunitet të veçantë, apo një grup më të gjerë të komunitetit, me synim në një zhvillim të qëndrueshëm të biznesit. Rreth 17 persona të pranishëm në tryezë patën mundësinë për të diskutuar më afër me përfaqësuesit e Forumit për Iniciativa Qytetare - Vjollca Islami Hajrullahu dhe Kushtrim Puka në lidhje me informatat për projektin në fjalë.

Kriteret të cilat u theksuan se mbi cilën bazë duhet të ndërtohet ky biznes plan, për tu kualifikuar për garën e madhe regjionale që do të mbahet gjatë muajit Korrik 2013 janë

1. Idea duhet të jetë në fazë embrionale apo diçka që sapo ka filluar.
2. Të jetë e zhvilluar në më pak se dy vjet dhe të hyrat vjetore mos të jenë më të larta se 10,000 euro.
3. Të jetë krejtësisht e bazuar në burime lokale.
4. Të ketë një plan të detajuar apo të jetë ide e detajuar e të qenurit miqësor me mjedisin.
5. Punëson njerëz lokal dhe shkatësitë e tyre tradicionale.
6. Ka një plan apo ide të detajuar për rritje sistematike.
7. Individit apo biznesi duhet ta ketë vlerësuar tregun lokal t'i njeh konkurrentët dhe avantazhet krahasuese.
8. Ajo do të mbështesë rigjallërimin e ekonomisë tradicionale lokale dhe lidhjen e njerëzve me këtë ekonomi.
9. Idea duhet të jetë unike dhe të mos ketë mbështetje monetare nga qeveria lokale, qendrore apo agjensionet zhvillimore ndërkombëtare.

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë me idetë e tyre të biznesit deri më 30 Prill 2013, duke dërguar një dokument të detajuar (Word apo në Power Point) në adresën elektronike: businessplan@fiq-fci.org.